

85H-1

7 71

VANGJUSH TH. ZIKO



KËN GË
PËR
D U A R T

20

2

448-151

TIRANË, 1959

8P.1.883-1

20

2

173-176

8A-1

21, 65



Vangjush Thoma Ziko lindi në Korçë më 1931 në familjen e një zanatçiu orëndreqës. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin e Korçës.

Ka filluar të shkruajë e të botojë vjersha ndër organe të ndryshme që nga viti 1950. Ka marrë pjesë me brigadat vullnetare të rinisë në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Tiranë.

Në vitin 1956 mbaroi studimet në Institutin e letërsisë «A. M. Gerki» pranë Lidhjes së shkrimtarëve Sovjetikë në Moskë. Tani punon në Gjimnazin e Korçës «Raqi Qirinxhi» si pedagog.

891.983-1

Z 78

VANGJUSH TH. ZIKO

5
~~26046~~

14291

8A-1

Zi 65

SHTETI
GJIRKASTER

KENCE PER DUART

Ujersha

N.SH. Botimeve «Naim Frashëri»:
Tiranë 1959.

14

Redaktor: Drago Siliqi
Redaktor teknik: Pal Doçi. Piktur Fatmir Haxhija,
Korektore letrare: Donika Omari

Tirazhi 1500. Formati 70 x 100 1/32. Stash 2204-55.

Shtypur në NISH shtypshkronjave «Mihal Duri».

MONOLOGU IM

Kam një çerek shekulli që bredh
Përmbi dheun tem dhe faqe librash,
Kam mbi supet pluhur që ta hedh,
Kam në gjoks shkëndi dhe tinguj lyrash:

S'linda un' një dit' në socializëm,
Udhës jet' e re mua më gjeti
U mëkëmba n'odën me konizëm —
Hiri i kandilit mbi sup mbeti.

Dolla nga një rrug' e ngushtë fare
Ku shtëpitë shtrydhnin njëra tjetrën,
Me të errta perde në dritare,
Ku në katër mure mbyllnin jetën.

Dolla nga dyqan' i zanatçiu
Ku ndërgegjja pranë kish gënjeshtren,
Dhe në shpirtn' e njomë prej të riu
Shkula atë gjeth që ndillte vjeshtën.

Dolla. . . Jo! Më nxori një kasnec,
(Po mos ish Ay-as unë s'qeshë);
Syt' Ay m'i hapi, më tha: — Ec!
Që njeri mos kthehet — thur ti vjershë.

VËSHTRIM I DËSHMORIT

Nurja pse është' nxehur shumë,
Fjalët rëndë pse i shkojnë,
Pse me grusht e godet gjunë,
Sikur rreth nuk e dëgjojnë.
Flet për fenë, për namuzë,
Se këshilla keq po rrejnë.
— . . . : Malësisë dhe në Gurzë
Vajzat pragon s'kapërxejnë! . . . :

Ç'po ja pret ajo syzeza,
Që si prushi syt' i digjen.
Bën ta ndalë nëno-zeza:
«Heshtë» bijë, moj Saide!»

Mos iu tremb, nëno; asaj:
O sa mirë ështëë matë:
— Dhashë fjalën, do ta mbaj;
Për dy ditë nisem, tatë!

— Ej; këtu kush kumandon!
Guralia ështëë gjallë! —
Grusht' i tija e rrëzon
Bijën, njomzen nëpër shkallë. . . :

* * *

. . . : S'e zë gjumi Guralinë,
Nuk gjen vënd për të pushuar;
Po e mat me hap shtëpinë
Vetull-rëndë, sy-lëshuar.
Dhe afrohet Nure plaku
Të shikoj' resmen e djalit
Dhe afrohet pas oxhakut,

Po e dobët drit' e ballit;
Shkund kandilin e venitur,
Po e zbehtë drit' e vajit.

Thua djali flet pa pritur:
«Ajo shkon për dritë Matit!»
Hedh me ngulm vështrimn' i ati z
Drejt në sytë e ushtarit:
— Po zakonet që të parit?!: : :

Djali flet e nuk flet dot,
Se është' tretur tash sa mot;
Po vështrim' i tija flet,
Po vështrimi shpirtin vret. z

RROGA E PARË

Neta sot qe e gëzuar.
Teto viti e kuptoi:
Dera jasht' u hap nxituar
Zilka ethshëm tingëlloi.
Neta vinte gjithnjë fshehur
Si një foshnjëzë fajtoe,
Dhe i lutesh të mos bjerë
Asaj zilkës shamatore.
Ajo sot u fut rrëmbyer,
Ja kish nderë flokët erës,
Përmbi faqet i qe kthyer
Ngjyra rozë e pranverës.
Zemra rrihte si e pirë,
Sytë lehtë kishin qarë,
Prapa grushtat e dërsirë
Fshihnin rrogënë e parë.

Neta ishte çupë fshati
 Rritur varfër, pa kimet;
 As e pyetën: iu hodh shtati,
 E martuan në qytet. . . :
 Burri pinte shumë, dëndur,
 Dorën e kish plumb të rëndë;
 Dhe zakon e kishte bërë
 Gjithnjë zërin lart ta ngrërë:
 «Ti zanat e punë s'di,
 Ja këtu, këtu më rri! . . .»
 (Edhe dorën tërë lesh
 Prapa zverkut e pëlciste)
 Matej Neta që t'i thesh:
 «Unë dua, po. . . » — Ja priste:
 «Ti, e dyta shterpë je;
 Vit i dyt' — fëmijë s'ke!»
 Neta hiqej zvarrë-zvarrë
 E i puthte këmbën, gjunë:
 — Ku të shkoj e zeza unë,
 Mbamë, mbamë hyzmeqare!

Eh, moj Net' e 'gjora Neta,
 Kaq' e egër qënka jeta?
 Vallë fjala drejt e thotë:
 «Fati thyhetë si gotë».

Fryu e lagur er' e {Kreshtës
 Gurët, xhamet i spërkati,
 Dhe s'pushoi shiu i vjeshtës
 Gjer ku soste udh' e fshatit.
 Po më kot Neta u lag,
 Kot trokiti mu në portë,
 Nuk e la të shkel' në prag

Ky babai kokëfortë.
Ay plakës i dha shqelmin
E rrëzoi nëpër shkallë.
Bubullima mbyti helmin,
Lotët, lutjet dhe çdo fjalë

Ra e ra shiu i vjeshtës
Prroi i vogël u bë det,
Solli ujra larg prej {Kreshtës
Preu rrugën për qytet:
O ti lumë, lum' i vogël,
Kaq i turbull pse po vjen?
Vallë kaqë baltë lanë
Shekujt përmbi vëndin tem!.
Pse ja rreh, ti, pulpët Netës
Pse e shtyn, ti, me rrëmbim,
Nuk e sheh fytyrn' e zbehtë
Ja errsoi një mendim?.
Shëmbi gurët, shkuli shelgjet,
Mbushi gropat, mbushi pellgjet!
Zgjatni degët dushqe, ferra,
Se po mbytet Net' e mjera!.

Në qytet po kthehej turni
Nga fabrika; dhe puntorët,
Gra e çupa shpejt u turrën
Nëpër rrugën më tërthore.
Aty ndodhi dhe një plakë,
Tetó Viti duarhekur,
Ajo Netën zu për krahu
Dhe e nxori gjysmë vdekur.

* * *

Neta sot qe e gëzuar.
Teto Viti e kuptoi:
Dera jasht' u hap nxituar,
Zilka ethshëm tingëlloi.
Neta vinte gjithnjë fshehur
Si një foshnjëzë fajtoje,
Dhe i lutshe të mos bjerë
Asaj zilkës shamatore.
Ajo sot u fut rrëmbyer,
Ja kish nderë flokët erës,
Përmbi faqet i qe kthyer
Ngjyra rozë e pranverës.
Zemra rrihte si e pirë,
Sytë lehtë kishin qarë,
Prapa grushtat e dërsirë
Fshihnin rrogënë e parë:

Teto Viti fort e puthi,
Sikur ta kish çupë vetë,
Dhe me zemër i uroi
Lumturi të ket' në jetë.

VAJZA FJONGO-KUQE

U ndal maqina. Zbriti një njeri.
Një vajzë që me boçe nëpër duar;
U kthye përshëndeti me shami
E mori atë shpatin e lakuar.

— Ku shkon kështu, moj qyqe! — tha një «zonjë»
— E mjera fat të zi që paska pasë! ...
Një plakë bëri kyrqin ta bekojë;
Shoferi i ra borisë tërë gas.

U nis maqina: Rrotull vetëm male,
Mësonjs' e vogël ngjitet, diç mendon;
I digjet në gërshet një fjongo alle
Dhe fillad' i bjeshkës fjongon ledhaton.

Me të dikur një kukëll është lidhur,
Po doçkat që e lidhnin janë tretur.
Ajo kujtim i zjarrtë dhe i hidhur
Në flokët e së motrësë ka mbetur.

E digjet ajo, skuq e përvëlton,
E fëshfërit, e zemrës gjith' i flet:
Si nën' e shkretë hoxhës i besoi
Të bijën të sëmure katër vjet.

Të ashpëra që janë këto male,
Një pare qiell mbi krye kaltëron;
Po shpatin ngjit një vajzë fjongo-alle
Andej ku fshat' i humbur po pushon.

NJË TAKIM NË UDHË

Kur pigen shokët, puthen fort
E malli flet e s'e mban dot;
Pa shpirt' i zjarrtë, shpirt' i ri
Nuk rri pa pyetur: «ç'bën tashi?»

Kështu takuan në një tren
Dy djem të rinj të brezit tem.
— Jam në minierë, vagonat ngas.
— Punoj për vehte. . . : (Matrapas?!)

Rreth flokët era me rrëmbim
E treni çfryn e turfullin.
Hesht minatori, nuku flet,
Tjetri me gjuhë fjalët nget.

— E paske dorën pa gishtrinj,
Mos i ke lënë nën shkëmbinj?
— Në male dje, po, me maljer. . . :
Më duket ti që infemjer!

Rreh flokët era me rrëmbim
E treni çfryn e turfullin.
Hesht minatori, nuku flet,
Tjetri stacion' e afërt pret.

— . . . : Po, dirsë derdhëm edhe gjak. . .
Stacioni: Ja! Kujton ndopak?
E ç'ishin dit' plot marrëzi!
Rinia shkoi duhet qetsi.

Hesht minatori, nuku flet.
(Tjetri nga larg e përshëndet).
Rreh flokët era me rrëmbim
E treni çan e turfullin.

Një fije bloz' mbi plagë bje,
Po minatori nuk e sheh:
Me zjarrin, flagën kuvëndon,
Që gjoksin trenit po ja ngron.

ZANATÇIU

Dielli kish dalë mbi Moravë.
Nasi në punë u drejtua;
E mbylli portën mengadalë,
Po pranë portës s'u ndalua.

Ay harroi të bënte kryqin,
Kryqin që bënte përngaherë,
Harroi të pëshpëritë lutjen,
Që myshterinj Zoti t'i shpjerë.

Në xham e shoqja i trokiti,
Po s'ja dëgjoi Nasi zërin,
Kish ikur larg... Ajo për burrin
Nga kora kryqin shpejt e bëri:

E veç i bir' i zanatçiu
Po buzëqeshte i gëzuar:
Shikonte t'anë që i sigurt
Në punë ishte duke shkuar.

NËNA

Nëna end çorape;
Tringëllijnë shtizat.
Nëno, syza s'pate,
Sot s'i heq dot syzat.

Nëna thur fanellë;
Mez' i natës vate.
Nëno, kaqe thellë
Sytë, ti, s'i pate.

Nëno, ler çorapet!
Nëno, ler fanellat!
Rrudhat nëpër faqe
Si brazda të thella.

— Po të rri, mor bir,
Rrudhatë më shtohen.
Po të rri, mor bir,
Sytë më qorrohen.

'KËNGA E DUARVE

NËpit tem

— Piqe, ti, toke këtu,
Ç'më shikon vrënjtur kështu?
Emrin ti, Gimi ma ke
Vehtes ti «bulë» m'i thua,
Po a e di, pse i ke,
Ç'janë për ty këto duar!
Jo veç kallama të mbash,
Kalin prej druri ujdisur.
Nesër, ti, jetën do ngaç
Mëzin e saj të azdisur.

Mos dëgjo gjyshen ç'të thotë
(«Vijën, bir; fati ta preul»)
Erdhe i lirë në botë —
Ke pra në shpirt Prometheun.
Duart, veç duart e tua
Oh, mos i lerë të qeta,
Zgjidh për to, çfarë të duash:
Drapër, çekan, klarinetë.
Mos i mbaj duartë fshehur;
Para armikut mos dridhesh
(Po të thërriti Atdheu
Hasmit ti grykës t'i hidhesh).
Lulet e fushës lëmoi —
Flokët e buta të vashës,
Po qe se yj të kërkoj
Zgjati ti duart, t'ja marrësh.

— Ç'thua pra? Toke, voglush,
Doçkat pa dal të t'i puth.

* * *

Unë sytë mbyll dhe rri mendohem:
Ja ky është i fundit çasti im.
Dhe pa dashur mua më kujtohen
Sytë që kam ndeshur n'rruzullim.

Vallë sa do ketë sy të tillë
Syt' e mi mbi botë t'i kërkojnë;
Vallë do të ketë sy të tillë,
Që kur s'shohin syt' e mij, gëzojnë?

Unë sytë mbyll dhe rri mendohem.
Jetë veç të tillë do të donja:
Që për syt' e mi të pikëllohen;
Dhe armiqtë, po, le t'i gëzonja.

NË PUNË

Shkon në repartet inxhinjeri,
Përkthyesin pyet, kërkon Pandorën,
Që u dallua. . . : — Faleminderit! —
Asaj gjermani i zgjat dorën:

Po dora mbet ashtu e shtrirë,
Po dora mbet një çast e nderë,
Ay u drodh, u gjend vështirë:
Ajo të djabatën kish të prerë.

Ajo pastroi dorën në rroba,
U përshëndet ashtu si munda;
(Në syt' e saj u ngjall Borova,
Në vesh të saj kumboi plumbi. . . :)

Gjermani pa, kuptoi shumë.
E pa si lotin e gëlltiti;
I puthi dorën kokë-unjë
Dhe levën e motorit ngriti.

— AJO —

Ajo po ngjit kodrën nxituar
Baluket mbi ballë ngatruar,
E sytë dikë po kërkojnë
Po sytë nga lotët s'shikojnë.
E lotët ky fillad i pranverës
Më kot po përpiqet t'i terë —
Ata prapë mblidhen si sumbull
E faqes rrëshqasin të rrumbullt,

Rrëshqasin të hidhur, papritur
E dredhin at' buzën e mitur,
Ajo po ngjit kodrën nxituar
Dhe di që prap' kot është munduar,
Po digjet në zëmër një shpresë
E çastit si zjarr i rrufesë,
Dhe djeg aty thellë dyshimin
E ngroh plot me dhëmbje kujtimin...:
Ay u betua i pari
Me fjalët e shënjta në botë,
Ato i dëgjoi dhe bari
Dhe qielli i pastër si lotët...:

Në qiell mblidhen retë ngadalë
E gjethet s'lëvizin në pemë,
Mbi tokë, ja, kraku një galë —
Sa thellë sëmbon mu në zëmër!
Te plepat ku prroj rrjedh me zhurmë,
[Ku çel trëndafilja e egër,
S'ka ardhur ay... as ka gjurmë,
veç lulet shikojnë nga degët;
Veç lulja e vogël me erë
U drodh sikur diç e sëmboi:
U ul mbi petalet një grerë,
I mori nektarin... e shkoi...

Del ylli mbi maja me borë
E zoqtë foleve po mblidhen,
Mbi bar ajo qan kaqe orë
E supat e njomë i dridhen...:

Ja, fryu veriu nga malet
E gjethet diçka kuvëndojnë.
Shkel barin e njomë dhe ndalet
Një hije. Dy buzë këndojnë.

Këndojnë një këngë të ngrysur
Në zjarrin e epshit të tretur,
E shtrin përmbi vajzën e krrusur
Pëllëmbët çapkëni pa pyetur... :
(A ishte ay, apo tjetër,
Zemrën përçmimi goditi),
Ajo u tendos si purtekë
Këngën në buz'ja nemiti..

* * *

Përposh ndezi dritat qyteti,
U ndezë direktë, dritare... :
Kudo, kudo dritë të ketë
Njerzit në sy për t'i parë.

DUART E TIJA

Hedh dritën hëna mbi krevat
E Pandi s'flet rri zgjuar,
A thua hëna për inat
Ndrizon fytyr' e duar
Sikur s'e di ay që ka
Dy duar të fuqishme
Me to dërrasa ngre dhe tra,
Sqeparë në punishte.
Me to mobilje llustron lehtë
E dredh cigaren shtruar.
Po sonte ç'ka kjo hën' e zbehtë
Që sheh veç këto duar?
Ato s'i fsheh dot nën jorgan
Se prapë të rëndojnë,

E përmbi gjoks ato s'i mban
Se shpirtin turbullojnë.
A thua sonte s'i ka larë
Nga vajrat... papastruar:::
A thua... (dreqi që t'i marrë!)
Më s'duhën këto duar?!
Ato një shok nga të pushtetit
Me zëmër i shtërngoi,
Dhe emërin mezi u gjeti
Me ar i krahasoi.
Me të mobiljet llustron lehtë
Bën punë të qëruar,
Po sonte ç'ka kjo hën' e zbehtë
Që sheh veç këto duar?..

Hedh dritën hëna mbi krevat,
Në qoshen tjetër t'errët
Kjo ora kohën mat e mat
E prapë është herët.
Në qoshen mbledhur si një lëmsh
Qan gruaja me lotë,
Mbulon fytyrën që i dhëmb.
Po pse?... Askujt s'i thotë...
Hedh dritën hëna në krevat
E Pandi s'fle, rri zgjuar.
A thua hëna për inat
Ndriçon prap' ato duar!

* * *

Mëngjes. Shtërnguar pas krahorit
Të saj, fajtor ay pushon;
Lan rrez' e diellit dhe ndriçon
Duart e ashpra të puntorit.

GJUHËS RUSE

Se si ty të të falem nuk e di.
Një fjal' të vetme s'mundem që ta gjej,
Të shpreh në të dhe mall dhe dashuri,
Respektin tem të thellë të rrëfej.

Rusisht Homer' i lasht' më ligjëroi,
Ma hapi shpirtin libr' i njerëzimit;
E ardhm' e botës mua më kumtoi
Me gjuhën fjalë-zjarhtë të Leninit.

Si foshnjë mua shpesh më nanurisi
Një këngë ruse, kënga berjzore;
Krenarja fjal' e Gorkitë më grishi
Drejt majrave të mburrjes njerëzore.

Se si ty të të falem nuk e di.
Një fjal' të vetme s'mundem që ta gjej.
Kudo edhe ngado të kumbosh ti,
Un' sytë e mi të zemrës do ti kthej:

SHOKUT NGA URALI

Ti do ma njihnje mua zënë, Misha,
Sikur të të thërrisnja që së largu,
Me këtë mall, të fortë zë do kisha
Po prap' jehona s'kishte për të ardhur,
Larg jan' malet e mia majë-mprehtë
Nga pyjet e Uralit zemërtë,
Larg prej këtej është dhe Moska vetë
Ku ne të dy u bëmë aq të afërt.
Larg e prandaj edhe ky malli shtohet,

Prandaj dëshira për t'u parë zjen.
 Me shokët, Misha, ndofta dhe takohesh,
 Ti dhe për mua puthi kur i gjën.
 Këtu më luten, ç't'u tregoj më parë!
 Për Moskën pyesin që të gjith këtu...
 Eh, sikur vitet vrap mos kishin marë,
 Ne prapë të na kthenin n'Institut!
 Le të na jepnin dhomën që ne patmë,
 Ku furra ruse ngroh gjer në agim;
 Mban mënd, atje ma vutë ju krevatë,
 Se dimrin rus s'duronja në fillim.
 Dhe llamba le të ishte po ajo,
 Që netve të provimit s'shuhej fare,
 Tryeza le të ishte po ajo
 Ku për Atdhen' e shtrënjtë thurnim vargje:
 Atje çdo mur di fjalët që shqiptonim
 Të nxehur, me inat, a fare qetë,
 Kur natën përmbi kullat yjt' ndriçonin
 E diskutonim ne për vjershat, jetën,
 Për dashurin', mështekëzën e brishtë,
 Që gjithnjë shushuriste mu në prag...
 Ti më dëgjon, a më dëgjon, o Mishë,
 Ne jemi tok, pa çka se rrojmë larg:

TETORI I 1956-ës

Marshi i Kremlinit matur bie,
 Mëndja larg në Moskë po më shpie:::

Ja, konvikti ynë është hapur,
 Nga kufitë shokt' e largët vijnë,
 Dhe në dhomën, që ne kemi patur,
 Llamba prapë ndrit mbi tavolinë:

Ndrit, po veç fletoret nuku janë —
Përmbi to një hart' e madhe nderë,
Rrotull shokët; veç këtu Zolltanë,
Nuk e shoh maxharë, si ngaherë;
Po kërkojnë sytë shqetësuar
Një qytet të vogël buz' Danubit,
E lëviz mbi hartë dora ndruar;
Mos lëndojë plagët që la plumbi,
Thika e horthistit që i la.
Plagët që pa reshtur gjak kullojnë...
Ti qëndro, qëndro, Zolltan vëlla,
Po t'u desh gjak, ndajmë gjakun tonë...

Orët e Kremlinit po ushtojnë:
Internacionalen ne këndojmë.

NJË EMËR

Dashurisë së parë

Vajza u lind! Gëzimi i parë.
Ç'emër t'i venë, ç'emër të marrë?

— Emrin ja zgjedha: t'i themi Anë,
Emër i bukur, kumbon!

— Pse mos t'i themi asaja Svetllanë! —
Ai fjalën menduar shqipton.

— Anë, m'i ëmbël', emër i ngrohtë,
Në zemër jehonë le!
Burri pse hesht, e çfar' do të thotë,
Sytë e vrëjtur s'i ngré...

Erdhi një letër, letër e huaj,
Letër e nisur që larg.
Shkrimi i qetë, shkruan një grua;
Nëna e re mbet në prag,

Dora i dridhet: «: : Ç'bën, si ja shpie'
Dua i lumtur të jesh
Merr ti të fala prej Siberie:
Ndofta dëgjuar do kesh:
Ara ne hapëm, grunjat i çuam,
Zgjuam ne tajgën pa fund.
Lodhemi, po! . . . Ne mbrëmë dëgjuam
Radion këtu në katund;
Binte një këngë, asnjë nuk e dinte,
Veç unë e dinja atë.
Un' dolla në fushë, hëna po ndrinte,
Lëkundej berjoza pa zë. . .
Moskën kujtova, konviktin, studimet,
Kohë që s'kthehetë më!
Kur djalë të lind — mos vdesin kujtimet:
Emërin tënd do t'i vë».

Erdhi një letër, shkruan një grua,
Gruas ja thonë Svetllanë.
Nëna e re merr letrën e huaj
Merr dhe e fshehën mënjanë. . .

Vajza u lind, gëzimi i parë.
Ç'emër të marrë, ç'emër të marrë?

— Vajzës t'i themi. . . t'i themi Svetllanë: : :
Bukur sepse m'tingëllon. . . —
Burri ja puth dy sytë ngadalë,
Heshtur të shoqen pushton.

NJË DOLLI NË DASMË

Muzikë, muzikë, muzikë!
Një çast pa muzikë mos hikë.
Vallzoni, o këmbët e lehta,
Gëzimet rrëmbeni nga jeta.

Muzikë, muzikë, muzikë!
Dhe pleqtë të ritë kujtojnë.
Po radioja heshti. . .
Muzikë. . .
Jo, — Lajmet e fundit fillojnë!

«Sot bota në pragun e luftës,
Ngri dorën, Njeri; dhe e mbro! : : »

— Muzikë! Të shtira me kupë!
E ç'duhet në dasmë këto?
Muzikë!
Një çast pa muzikë mos hikë! . . .

— Muzikë? — E ndali të pirin
Ky dhëndri dhe ngriti potirin.

Nga radioja gjithë u kthyen.
Nën urdhrin kumbonjës t'efirit
Kupat përplot i pinë, i thyen,
Siç thyejn' kur ngrënë dollinë
Për ditët që duhet të vijnë.

— Muzikë! Po, veç me muzikë
Çdo çast përmbi botë të hikë!

PAQE!

Pse lindja e kuqe gjakun të kujton,
Krisma e derës — llozin e pushkës,
Reja e zezë kujtimet lëndon:
Fshatrat e djegur rrugve të fushës.

Mjaft! Dua lindja veç festë të ndjellë,
Zërin e mikut — krisma e derës,
Reja e zezë veç shiun t'u sjellë
Grunjave, pyllit, luleve verës.

TORBA ME DHE

*Agjentët e Titos rivalizojnë me zell e terror
me parardhësit e tyre për të zhdukur shqiptarët.*

(nga gazeta)

Dy duar rëmojnë në ledh,
Rëmojnë, grushtat i mbushin;
Në torbën me arna hedh
Dheun e shkrifët grushti.
Dheun e shkrifët, të vlagët,
Dheun e zi porsi rrëmba,
Dheun me erë të vakët,
Dheun me bar edhe gjëmba.

Dy duar rëmojnë në ledh,
Rëmojnë, torbën e mbushin;
Veç ylli, hëna i sheh,
I sheh një hije në fushë.

Dy duar rëmojnë në ledh,
Rëmojnë, grushtat i mbushin;
Në torbën me arna hedh
Dheun e shkrifët grushti.
Dheun ku luletë ndehen,
Përzjerë me gjethin vjeshtak,
Dheun ku gjyshërit prehen,
Dheun me djersë dhe gjak. . . :

Duartë vjedhin dheun,
Dheun e tyre po vjedhin!
(Arën çetniku e bleu —
Larg kosovarët i hedhin).

Dy duar gërmojnë dhe,
Gërmojnë, torbën e mbushin.
Nata e kthjellët po fle.
Një hije lëvizi te bushi.
Një hije lëvizi. . . dhe «krak!» . . .
Zoqtë e fushës u zgjuan.
Dheun e lyer me gjak
Duart e rënda pushtuan. . . :

* * *

Në zyrë u fut udebashi,
Nderoi ay,
raportoi:
— Sonte u vra Sul-Turbashi,
Duket, çetniku qëlloi.

Qartë! Hidhe në gropë!
Çështja të mbyllet! Shko! —
Piu oficeri një gotë
Dhe fishkëlloi një tango:

NJË ANKETË

VENDLINDJA

U linda, u rrita tek ti, Shqipëri,
Me male, shqiponja dhe qiell mavi.

Prandaj më këndoi dhe nëna në djep:
«Do fryjë stuhia — po ty nuk të hep».

E natën e errët prandaj s'e durova
Me krahët e mia drejt diellit u çova.

Prandaj vajz' e dashur më puthi e tha:
«Sy kaq të kulluar në botë nuk ka!»

U linda, u rrita tek ti, Shqipëri,
Me male, shqiponja dhe qiell mavi.

TË AFËRMIT

Kam nënë, një nënë dhe unë,
Çdo nënë në botë i ngjet;
Babaj përkëdhelje s'di shumë
Menduar gjithnjë ay flet.

S'kam motër; vëlla nuk kam patur,
Po zemra atë prap e njeh:
Një ndjenjë të zjarrt' e të matur,
Që shpirtin' e vëllaut veç nxeh.

Me të më mëkoi që herët
Kjo jeta në rrugët e saj,
Nër 'to kam takuar sa njerëz
Me zemër të pastër vëllaj.

FEJA

Besoj më një Zot,
I falem atij,
E Zotin këndoj
Me emrin NJERI.

LULJA E EGER

I

E çfarë fsheh ky emri yt,
E çfarë vallë më kujton?
Sa her' e ndjej zemra më dhemb;
E malli i zjarrtë më pushton.

Lëndinat plot me luleshqerë
Më dalin para një nga një,
Dhe shtërg i bardhë lart në erë
Dhe ëndrra ime tok me të:

Llastik e hedhur në një cep
Si arm' e vjetër e përçmuar;
Një gjysmë krëhëri në xhep-
Si pasuria më e çmuar;

Ky libr' i shkencës hapur fare,
Po veç një emër aty gjen...
Kujtoj unë netët argjend-larë,
Kur hëna ndrit e gjumi s'vjen...

Ku ini ditë miturake!
(Na ndjell përpara jeta vetë).
Po nuk harrohet kurrë praku
Nga hodhëm çapin për në jetë.

II

S'më flihet mua, s'më flihet,
Po bien lulet e mollës,
Po bien lulet e bardha
E hëna qetë ndriçon.

S'më flihet mua, s'më flihet,
Shpirti s'eç më ka humbur,
Se ç'iu këput me ballonin
E fëminis'... e i shkoi...

S'më flihet mua, s'më flihet,
Zemra diç po më ndjell
Të re, të ngrohtë, të madhe,
Që mëndja dot s'e pushton.

S'më flihet mua, s'më flihet,
Molla e njomë po lidh...:
O moll' e bardhë, më thuaj
Në zemër time ç'po lidh?

III

Nëno, pse s'më bëre më të bukur,
Pakëz, nukë desha yll të shkruar
Kaq vështirë ndofta s'do m'ish dukur
N'ato syt' e saj për të shikuar?

Jo, moj nëno, kot po më lëvdon,
Ti s'ke faj e s'ke pse zëmërohesh,
Në rini kjo zemra e kërkon
Dhe ke qejf nga pakëz të krenohesh.

Po në s'linda unë aq i bukur,
Dashurin' pse duhet ta përmbaj?
Me të ashprat duar punëtore
Do t'i ngre të bukur jet' asaj.

IV

Po e ndjej sot vehten kaq të rritur!
Gaz i madh në shpirt më ka trokitur:
Sot ma ngrohu zemrën një dëshirë,
Që të ndajmë tok shtratin e dlorë,
Bukën, ujët, lulet e planetës.
E t'i bëjmë ballë bashkë jetës.

V

Ditë kam që pres e nuk pres dot,
Pse s'kujtohesh vallë, pse nuk vjen?
Në s'më do -më thuaj që s'më do;
Se mëshirën zemra ma urren.

E po qe se s'duan të të lenë
(Vetëm kësaj fjale i besoj),
Se dikush na vuri në mes fenë...
Dashurisë vetëm i besoj!

Pleqtë ne na rritën, na mëkuan,
Thinjët e argjenta ua nderojmë.
Veç se jetën tonë neve duam
Siç na thotë zemra ta ndërtojmë.

VI

U rrit mbi shkëmb një lul' e egër
Ku asnjë shteg drejt saj s'të çonte,
Ku vetëm ferrat shtrinin degët
E fllad i kaltër fluturonte.

U rrit mbi shkëmb një lul' e egër,
Drejt saja shtegun vet' e ndeva,
I shkela ferrat deg më degë
E flladit krahët i rrëmbeva.

VII

Me nënën nxuarrtë pagdhirë
Djepin me pluhur të mbuluar
E latë gjat' e fshitë mirë,
Pastaj ngadale e lodruat.

Plaku u ngrit i shqetësuar
Shaminë shpejt zu ta kërktojë.
Trokiti zemra në krahuar
Që dit' e gazit ta dëgjojë.

T'i sjellim djepit që na çoi
Një mik të ri, mos rrijë qetë,
Dhe dashuris' që na bashkoi—
Një tempull ku të rroj' përjetë.

Dhe plaku që beson më zotnë
Të shkoj' i qetë, i gëzuar;
T'u thot' stërgjyshve «n'atë botë»
Se fisi paska të vazhduar.

T'u sjellim viteve që vijnë;
Një ndërtimtar më me pervojë;
Ato që neve s'do arrijmë
Ay më tej le t'i ndërtojë.

KËNGA E BUZËVE

I

Ti shegë ke ngrënë,
Qershi ke kafshuar,
A vezët e pashkës
Nga një ke provuar?
Dhe dielli i zjarrtë
N'agim u gënjye,
Me rrezet e ngrohta
Ndaj teje u kthye.
(Puth dielli mbi dhe
Më parë burbuqet)
Aman, ç'e gënjeve
Me buzkat e kuqe.

II

E di pse i dua
Un' buzkat e tua?
Se flasin nxituar:
«Të dua! Të dua!»

I dua kur dridhen
E dot s'më qortojnë,
Veç buzët e mia
Inatçëm kërkojnë.

Kur duken të qeta
E leht' fishkëllejnë,
Po dridhjen e tyre
Në çip dot s'e fshejnë.

E di pse i dua
Un' buzkat e tua?
Se dridhen kur thonë:
Të dua! Të dua!»

III

Të kuqtë ti lere
Mbi buzë mos verë;
Në hiku pranvera —
Mirsardhe, moj verë!

IV

O rrudhzat e para,
O rrudhzat shqetsonj'se —
O ngricat e para
Të stinës kërcnonj'se!

(Po, dimër' i egër
Lumenjtë mbërthen;
Veç ujët e gjallë
Nën' akull gjith zjen.)

Dhe ngricat e para
Mbi buzkat e tua,
S'e shuajnë zjarrë
E fjalës «Të dua!».

NATYRA

1

Natyrën më pëlqen si libër ta çfletoj
Të rri e ta dëgjoj si simfoninë;
E më pëlqen krenar mes saj të shkoj
E të këndoj un' këngë për njerinë.

2

Ato kodra t'i shoh dhe n'ëndërr i dua.
E dua t'u ngjitem ngadalë
Menduar, pa këngë, pa fjalë;
Të rri përmbi gurët e rëndë
Ku derdhin hardhukat ergjëndë.
I dua guriçkat dhe plisat,
Dy lisat e moçëm te kisha.
Korien në buz' të rrëpinës
Dhe qiellin, sa syri ta zë;
Dhe klithmën e mpreht' t'gjeraqinës:
Të ndjell fëmininë me 'të.

3

Tre plepa rriten majë një kodrine.
Tre plepa shtatin ndejn' në suferinë.

Të tre për çdo pranverë lulëzojnë
E dielli, retë, toka i mëkojnë.

E plepat, kur lind dielli, e presin
Me hymnin shumëtingujsh të mëngjesit.

Kur ret' e murme tufë-tufë shkojnë
Ata përuhin kryet i nderojnë.

Kur vjesht' e artë vjen në gji t'i rrokë
Ata florin' e derdhin përmbi tokë.

Tre plepa rriten majë një kodrine
Tre plepa shtatin ndejn' në suferinë.

E tre djalosha dje ata i mbollë
E ëndrra sa të bukura që ndollë!

Po vdiq djaloshi i parë, vdiq papritur,
Kur plepat ende nuku ishin rritur.

Djalosh' i dytë ra përmbi kodrinë
Kur mbronte këta plepa — Shqipërinë.

I treti vjen menduar u dhel koren
Me duartë e ashpra punëtore. . .

Tre plepa rriten majë një kodrine
Krenarë, si bajrakë të tre rrinë.

4

O ju netë, netët e pranverës
O ti stin' e blertë buçimtare!
Ç'i kujtoni zemrës përngaherë
Aromatn' e moshës djaloshare.

A më njeh, o fllad, un' prapë jam,
Flokët veç më janë fort ralluar,
E në zemër, thellë ndofta kam
Nonjë breng', që ty s'ta kam treguar.
(Jeta është jet' e ne ushtarë,
Lumturin' e gjejmë ne në luftë,
Ne do bëjmë jetën që ta marrë
Dorën ton' me kallo e ta puthë).

O ju netë, netët e pranverës,
Nuk jam djalërinë duke qarë,
Ne atë e humbim për ngaherë,
Që të rroj' në stinën buçimtare.

5

Kur grur' e thekur e shikon
E çfarë vallë të kujton?
Nuk dua, jo, të kujtoj arin,
Kujtoj veç duart e fshatarit,
Duart' e zeza e të rënda,
Që dielli thek e vret parmënda,
Duart, veç duart e fshatarit —
Emrin e tyre, vodhi ari.

6

Në tokë bujku farën hodhi.
Kjo er' e lagur drurët drodhi.
Ja vdiq natyr' e gjelbëruar
E zoqt' e trembur qiellin muar...
Veç toka hesht, n'mendime rënë,
(Duron dhe shiun, dëborën pret)
Gëzon si gruaja, kur nënë,
Papritur, ndjen vehten e vet.

RUBAIRA

DETI

E dua detin se është' i gjerë,
Ngjyrën e tija e dua unë;
E dua detin se s'di të flerë,
Se ball' i tija ka rrudha shumë.

MALET

Pse përulim kryet para tyre
Dhe kreshnike këngë u këndojmë;
A na tremb kjo hieja e tyre
A atyre duam t'u ngjasojmë?

PYJET

Pyjet kurrë nuk flenë,
Hymnet e blerta këndojnë
Njerzit e ndershëm që bjenë
Ata që jetën fillojnë:

YJET

Ka në botë shumë ëndrra —
Ka në qiej yj të zjarrtë,
Po të duket yll' i zemrës
Më i ndritur, më i artë.

ZJARRI I JETËS

Ra shkëndia-zjarri mori flakë
Digjet ay, digjet edhe ndrin.
Ay di se po të shuhet pakë
Atë hir' i ftohtë e përpin.

ARTI

Dheu ynë s'ka veç gjelbërim—
Skërka edhe pluhur ka në jetë;
Po mos ishte arti — në ç'burim
Shpirti ynë do pastronte fletët?

MUZIKA

Njeriu pa diell s'do rronte,
Pa fjalët — do çmëndeje ai;
Po pa muzik' s'do shijonte
Aromën e shpirtit të tij.

DASHURIA

Dashuria është porsia zog —
Qiejt' e kaltër di veç të sulmojë;
Kur plagosur bie përmbi tokë
Kaltërsinë prap' do të pushtojë.

MALLKIMI

O ju, në mallkofshi njeri
Urojini jetë të qetë:
Mos e trazoj' gjumn' e tij
Ëndra e zjarrtë me fletë.

DUARTË

Pesë gishta dhe pesë — dhjetë,
Ja, këta endin gjith' këtë jetë.

SPUTNIKU

Bibl' e trashë thotë: «Gjithësinë
Zoti dhe e Shënja Frym' e bënë...»
Në patëm krijuës Perëndinë —
Ne kolegë sot me të u bëmë.

MBAJTËSIT E ÇEKANIT DHE DRAPËRIT

Ne ardhëm në botë të rrojmë,
Ne lindëm me duar puntori:
Me njëren shkëmbenjtë dërmojmë,
Me tjetrën fitoret i korrim.

SHEKULLI XX

Në anën e majtë shiriti i zi
(Kujtim i atyre që luftrat mbuluan)
Përmbi shiritin, në sfondin mavi-
Pëllumbi, që vajtjet, guximi e çuan.

BALLADA E VAJZËS SË NIZAMIT

I

— Lule, mos dil malit
Se mënxyrë ndjell,
Se kjo këmb' e djalit
Nuk mendon ku shkel.

— Djali shkon mënjanë
E më sjell verinë,
Djali më vjen pranë
E më lëmon gjinë.

— Lule, mos dil malit
Mos dil e çkujdesur,
Se kjo këmb' e djalit
Të shkel duke qeshur.

II

Thonë ra dëborë malit
Pa u drodh mënjolla: . .

— Ej, shtërngoi frenë kalit! —
Thirri kjo mes-holla.

— Vashë, mos ma shaj dorinë,
Po të ndjek revan.
Vashë, pse më mban mërinë,
Pse shikon mënjanë?

III

— O bilbil, nga mali ç'erdhe;
Pse xëbrite poshtë jazit,
Mos ta prishi atë çerdhe
Edhe ty dëbor' e marsit.

Po mos qaj, o zog i mjerë,
Ma këpute shpirtin ti;
Do të vijë prap pranverë
E do nxjerrësh zogj të rinj.

Do buçasë pyll' i dendur
Dhe ferrishta do bulojë,
Veç vllastari im i hedhur
Majë shkëmbit s'do blerojë.

Ku ta ngre, bilbil folenë—
Ku ta bëj un' varrin tem.
Shkojnë zoqtë — prapë kthejnë
Veç nizami im nuk kthen.

IV

-- Lule moj; të thashë
Mos dilnje malit
Lule moj; të thashë —
Të shkel këmb' e djalit.

— Djali nuk më shkeli
Veç më përkëdheli;
Po kodrave dolli
Zabit i Stambollit.

—Nuk i ngre dot sytë, djalë,
Me lot m'i rëndove, —
Dje më puthe, më dhe fjalën,
Sot vajte kallzove! : .

—Trëndafil me gjëmbe shumë,
S'i kam thën' njeriu!
Në dëgjoi njeri në gjumë
C'faj kam un' i ziu.

Në u foli grave kroi
Fjalët që i thashë, —
Kur e pashë më kujtoi
Syt' e tua vashë.

Në i tha pyllit mënjolla
Emrin që i ngjita, —
Më kujtoi bel' e hollë
Kurmin tënd, moj dritë.

Në përhapi era fjalët
Dhe dëgjoi fshati, —
Të kam thirrur mengadalë
Se më vrau fati. .

Prit moj, prit moj! — klithi djali—
Shkoj nizam Stambollë! .

Thonë ra dëborë malit
Pa u drodh mënjolla.

BALLADA E SHPATIT

— Ej, dëgjoni këngën
Veç mos shihni vëngër,
Fjalët m'i besoni,
Bregën ta dëroni. —
Këtë këngë t'egër
Këndon nëpër degët,
Në degët e rrapit
Kjo era e Shpatit.
Era fryn me vjete—
Kënga është' e vjetër.

* * *

Krisi një martinë
Iu përgjigj një tjetër.
— Krushqit, krushqit vijnë
Mbi kuaj të lehtë!

E u çel Abazi
E drodhi mustaqen,
Pagurin e zbrazti —
Lagu buzët, faqen.
E u ngrit i pari
Në oborr të dalë,
Po në prag e ndali
Motr' e tij pa fjalë:
Motra sy-përlotur,
Motra flok-lëshuar,
Bën të mbyllë portën
Po s'i bëjnë duart:

— Ngriu më t'u thafshin,
Si u mbyllka porta!

— E mbaruam dasmën
Më t'u bëftë motra!

— Ngriu më t'u thafshin
Se po qesh dynjanë!
Sa filluam dasmën
Krushqit ja ku janë!

— Mbylle, Baze, portën
Veri lloz' e ahut;
Mbylle, Baze, portën
Çupa vehten vrau!

Dairja pushoi—
Nusja vehten vrau!
Zurnaja vajtoi —
Nusja vehten vrau!
Mbylle, Baze, portën
Çupa vehten vrau!

— Të mos mbyllësh portën,
Të veshësh të motrën!

* * *

Ej, dëgjoni këngën
Vec mos shihni vëngër,
Fjalët m'i besoni,
Bregën ta duroni:
Këtë këngë t'egër
Këndon nëpër degët.
Në degët e rrapit
Kjo era e Shpatit:

Më të dal' të fshatit
Dy rrugë të ndara;
Njëra ngjitet malit
Tjetra shkon në varre.
Në të parën nuses
Krushqit i këndojnë;
Në të dytën krusen
Plepat e vajtojnë,
Gjethet e përthara
Tokën e mbulojnë,
Gurët përmbi varre
Heshtur po dëgjojnë.

— Eh, moj dos' e tatës,
Purtekë argjëndi,
Pse ia shkele tatës
Besën dhe kuvëndin.
Të zgjodha një burrë
Sërma xhamadanin,
Ç'e deshe, moj dosë,
Ç'e deshe jaranin!
Atij sa i plasi
Mustaqja e njomë —
E marrin nizam
Syrgjyn e dërgojnë.
O andej i lëntë
Koskat dhe nishanë!
Këtë fat mbi tokë
Varfëria kanë. . .

Gurët heshtur rrinë,
Varret heshtur s'rrinë:
Krisi një martinë!
Pyjet oshëtinë —
Krisi një martinë!
Plepat n'erë ngrinë —
Krisi një martinë!
Bazja s'mban dot gjakun:
Një trim mori hakun.

* * *

Këtë këngë t'egër
Këndon nëpër degët,
Në degët e rrapit
Kjo era e Shpatit;
Era fryn me vjete
Kënga është' e vjetër.

GJUHA E PRERË

Mësonjësve të parë të shqipes

...Çizm' e bimbashit pluhur ngre
Kamzhik i tija plagë le:

— Dhaskal, e ç'vivëll lexon ti?

— Një vivëll shqip, mor efendi!

— Po ku e gjete nuk më the?!

— Bimbash, për besë, që s'ta fsheh.

E sheh ti, lisiin qindvjeçar —

Te ay fletët un' i marr.

Në qiell shqiponjën e shikon —

Pendën ajo seç ma dhuron.
Dhe kallamari im nuk shterr —
Ky popull lotë derdh dhe vrer.
Terr' e natës urrejtja ndrit
Për atë turkunë e lik. . .

Çizm' e bimbashit pluhur ngre
Hanxhar i tija plagë le.
Mbi dhe kjo dor' e tija flak
Një copë gjuhë lyer gjak. . .

* * *

Bimbashi dolli mu në mal
E tërë qef kalin e ndal:
Mbi sytë dorën strehë ve;
Kallinjt' e fushës-një mbi dhe,
Fryn flladi, fryn e dot s'i ngre;
Nget era dheun ç'u zhurit,
Veç lisi i fshatit sa kleit;
Një nënë heshtur mbi varr qan:::

—:::Ë folë, qen Harbutistan!:::

O në ke vesh dëgjo bimbash,
Një plumb me krahë vjen nga pas:
. . . Më kot! Nga dheu s'ngrihesh dot.
Gjuha e prerë diç do të thotë.

BALLADA E LISAVE

Gueriljeve të Korçës

Dy lisa mbi kodër qëndrojnë.
Dy lisa rreth botën kundrojnë
Dy lisa me degë të ndera
I rreh ata breshri dhe era;
Po nuk i përkul er' e marrë,
Veç degët ngadale kërcasin,
Qëndrojnë ata si ushtarë
Dhe lëndet me plumbat u ngjasin.

Po, lëndet si plumbat u ngjasin
E lisatë gjall si ushtarë
E mua gjithnjë seç më flasin
Për natën, kur fryj er' e marrë. . .

. . . Më zgjuanë krisma të thata
E unë pas nënës u struka.
— Ç'u trembe! Kërciti kanata,
Ja lisat kërcasin te gryka. . .

Po jashtë, s'tërbonte veç vjeshta,
Në kodër nuk frynte veç erë,
Shkreptinte rrufeja mbi kreshta
Me flakë baruti përzjerë.

E lisat mëngjesit më folë
Të fshehtë, e natës me erë,
Me gojën e fletve më folë
Në ngjyrën e bakrit përzjerë. . .

S'i ngjeu veç vjeshta dy lisat
Në ngjyrën e bakrit s'i ngjeu!
Mbi kodër dy rojet fashiste
Lëngonin të shtrirë për dheu...

Dy lisa mbi kodër qëndrojnë
Dhe gjithë orizontet kundrojnë:
Dhe sa ndjehet larg vjesht' e marrë
Kujtimet ndër gjethe buçasin,
E lisat më duken ushtarë
E lëndët me plumbat u ngjasin.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Monologu im	3
Vështrimi i dëshmorit.....	4
Rroga e parë	5
Vajza fjongo-kuqe	9
Një takim në udhë	10
Zanatçiu	11
Nëna	12
Kënga e duarve.....	12
Në punë	14
Ajo	14
Duart e tija	16
Gjuhës ruse	18
Shokut nga Urali	18
Tetori i 1956-ës	19
Një emër	20
Një dolli në dasmë	22
Paqë	23
Torba me dhë	23
Një anketë	25
Lulja e egër	26
Kënga e buzëve.....	30
Natyra	32
Rubaira	35
Ballada e vajzës së nizamit	38
Ballada e Shpatit	41
Gjuha e prerë	44
Ballada e lisave	46